

Prej shtatorit 2017 Bashkia Gjirokastrë është pjesë e projektit “Bashkitë për në Europë” financuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt vjen si rezultat i një marrëveshjeje mirëkuptimi e firmosur më datë 5 Dhjetor 2016 midis Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore Z. Bledar Çuçi, Ministres për Integrimin Evropian Znj. Klajda Gjoshaj, Kryetarit të Shoqatës për Autonomi Vendore Z. Erion Veliaj dhe Kryetarit të Shoqatës së Bashkive Znj. Voltana Ademi.

Projekti do të zgjasë për një periudhë 18 mujore.

Fokusi i këtij projekti është rritja e kapaciteteve të autoriteteve vendore në Shqipëri për të përfituar fonde nëpërmjet pjesëmarrjes në programet e BE-së dhe gjithashtu do të funksionojë si një urë lidhëse për shkëmbimin e eksperiencave midis bashkive si dhe dialogun me Qeverinë dhe BE-në.

Në Bashkinë Gjirokastrë prej Dhjetorit 2017 është i hapur Këndi i BE-së tek i cili qytetarët mund të drejtohen në çdo moment, për tu informuar për praktikën, programet, apo edhe financimet e Bashkimit Evropian.